



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilimjen/Prodato Received/Delivety	13 - 12 2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHK	7451/2023		1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1367/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1367/2023 të datës 01.11.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit me numër Ref.ZSP-949/23 të datës 04.10.2023 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur, me datë 13.12.2023, mori këtë:

### V E N D I M

**I. Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.1367/2023 e datës 01.11.2023 e parashtruar nga ankuesja **Shfuqizohet** Vendimi me numër Ref.ZSP-949/23 i datës 04.10.2023 i zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe çështje kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë.

**II. Obligohet** Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij, duke shqyrtuar të gjitha kërkesat e ankueses.

**III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## Ar sy e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sipas Aktit të emërimit me Nr.3588, të datës 06.12.2013, në pozitën e punës "Shefe e Divizionit për Komunikim me Publikun", në Departamentin për Shërbime Administrative, përmes kërkesave për kompensimin e punës jashtë orarit dhe fundjavës dhe atë sipas kërkesës me Nr.851 të datës 03.03.2023, Nr.1427 të datës 06.04.2023, Nr.08.05.2023 si dhe Nr.2215 të datës 08.06.2023, i është drejtuar Udhëheqëses së Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me tre (3) ditët e punës gjatë muajit Shkurt, tetë (8) ditët e punës dhe ditëve të vikendit gjatë muajit Mars, për shtatë (7) ditët e punës dhe ditëve të vikendit gjatë muajit Prill si dhe nëntë (9) ditët e punës dhe ditëve të vikendit gjatë muajit Maj, të gjitha këto për kompensim me ditë të pushimit.

Njësia e Personelit përmes përgjigjes së datës 15.06.2023 ka njoftuar ankuesen së kërkesat e saja për kompensim të punës jashtë orarit, nuk mund të realizohen, pa ndonjë aprovim nga udhëheqësi i drejtpërdrejt.

Ankuesja më datë 20.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1015/2023, ndaj Divizionit të Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për shkak të mos realizimit të kompensimit të punës së realizuar pas orarit të rregullt zyrtar me ditë të pushimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 08.09.2023 ka nxjerr Vendim A.nr.1015/2023 përmes të cilit ka detyruar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të shqyrtoj kërkesat e ankueses.

Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 04.10.2023 ka nxjerr Vendim me numër Ref.ZSP.-949/23 me të cilin ka zbatuar vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku për punën jashtë orarit të rregullt të punës dhe fundjavës ankueses i ka njohur tri (3) ditë pune pushim.

Ankuesja kundër këtij vendimi më datë 01.11.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1367/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 09.11.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa, kjo e fundit, me datë 14.11.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6803/2023 të datës 01.11.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Ref.ZSP-949/23 të datës 04.10/2023 të zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Kërkesë për kompensimin e punës jashtë orarit dhe gjatë fundjavave me Nr. 851 e datës 03.03.2023 e ankueses; Emailin e datës 28.02.2023, 12.02.2023 nga F.M për



ankuesen; Kërkesë për kompensimin e punës jashtë orarit dhe gjatë fundjavave me Nr. 1427 e datës 06.04.2023 e ankueses; Komunikim me telefon 16.03.2023, 17.03.2023; Emailin e datës 17.03.2023 nga ankuesja për U.B; Emailin e datës 17.03.2023 nga ankues për B.A; Emailin e datës 15.03.2023 nga B.A për ankuesen dhe A.M; Emailin e datës 18.03.2023 nga F.M për ankuesen; Komunikim me telefon i datës 20.03.2023; Emailin e datës 21.03.2021 nga N.K për ankuese dhe R.D; Emailin e datës 20.03.2023 nga R.D për ankuesen; Emailin e datës 23.03.2023, 24.03.2023, 26.03.2023 nga F.M për ankuesen; Kërkesën për kompensimin e punës jashtë orarit dhe gjatë fundjavave me Nr.2215 e datës 08.06.2023 e ankueses; Emailin e datës 05.05.2023, 06.05.2023, 07.05.2023, 14.05.2023, 12.05.2023, 17.05.2023, 19.05.2023, 21.05.2023, 26.05.2023 nga F.M për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.11.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 14.11.2023; Akt Emërimit e datës 06.12.2013; Kërkesë për kompensimin e punës jashtë orarit dhe gjatë fundjavave me Nr.1878 e datës 08.05.2023 e ankueses; Emailin e datës 12.04.2023, 16.04.2023, 17.04.2023, 28.04.2023, 29.04.2023 nga F.M për ankuesen; Raportin e hyrje daljeve për ankuesen për periudhën nga data 01.02.2023 deri datë 31.05.2023; Shkesë për kalkulimin e ditëve t punës jashtë orarit dhe vikendeve; Emailin e datës 26.05.2023 nga F.M për B.H; Emailin e datës 29.05.2023 nga B.H për F.M; Emailin e datës 15.06.2023 nga F.M për ankuesen; Emailin e datës 20.06.2023 nga ankuesja për F.M; Emailin e datës 25.10.2023 nga ankuesja për V.Ç; Emailin e datës 26.10.2023 nga F.M për V.Ç.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave(në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit), pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Ref.ZSP-949/23 të datës 04.10.2023 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pretendon se me këtë vendim janë shqyrtuar vetëm dy nga katër kërkesat e parashtruara, ndërsa përmes kësaj ankese ka kërkuar që kërkesa të aprovohet plotësisht.

Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës konstaton se ankuesja lidhur me pretendimet e saj për kompensimin e punës jashtë orarit dhe fundjavës me ditë punë të pushimit, ka parashtruar disa kërkesa dhe atë kërkesën me Nr.851 të datës 03.03.2023, kërkesën me Nr.1427 të datës 06.04.2023, kërkesën me Nr.1878 të datës 08.05.2023 si dhe kërkesën me Nr.2215 të datës 08.06.2023 të cilën e ka parashtruar tek Udhëheqësja e Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kështu që në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses dhe gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesë konkretisht Vendimit me numër Ref.ZSP-949/23 të datës 04.10.2023 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, konstaton se sipas këtij vendimi nuk janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e ankueses ngase me këtë vendim është shqyrtuar vetëm kërkesa me Nr.851 të datës 03.03.2023 dhe kërkesa me Nr.1427 e datës 06.04.2023 të parashtruara nga ankuesja, duke theksuar se këto dy kërkesa kanë qenë të aprovuara nga ish Zyrtari Kryesor Administrativ, ndërsa kërkesat e tjera si kërkesa me Nr.1878 e datës 08.05.2023 si dhe kërkesa me Nr.2215 të datës 08.06.2023 nuk janë shqyrtuar edhe pse në bazë të dëshmive edhe këto dy kërkesa janë të nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me mbishkrimin për trajtim Divizioni i Personelit dhe Buxhetit. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sipas Vendimit A.nr.1015/2023 të datës 08.09.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës



respektivisht pikës I të dispozitivit të këtij vendimi, ka qenë i detyruar të shqyrtoj të gjitha kërkesat e parashtruara nga ankuesja.

Duke marr parasysh këtë fakt e që ndërlidhet me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit, konstaton se organi që shqyrton kërkesën/ ankesën e palës është i obliguar që të shqyrtoj të gjitha pretendimet e palës të ngritura përmes kërkesës/ ankesës dhe mbi bazë të shqyrtimit të drejtë dhe të tërësishëm të nxjerr aktin administrativ, si rrjedhojë nuk janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e palës ankuese sipas nenit 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Marr parasysh vendimmarrjen sipas Vendimit me numër Ref.ZSP-949/23 të datës 04.10.2023 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky vendim është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që si rezultat i kësaj, nuk është shqyrtuar në tersi, ngase duke qenë se vendimi i atakuar përmban të meta të tillë të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit vlerëson që lënda të kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje* tek Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me detyrimin që e njëjta të rishqyrtoj çështjen lidhur me rastin e ankueses konkretisht të shqyrtoj të gjitha kërkesat e ankueses, njëkohësisht e njëjta është e obliguar të eliminoj shkeljet e konstatuara sipas këtij vendimi dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë, respektivisht dispozitivi dhe arsyetimi i aktit të jetë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji i këshillit, duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.1367/2023, datë 13/12/2023

Avdy BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshme të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Arkivit të KPMSHCK-së.